



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

**V E N D I M**

**PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS PËR ZËVENDËSIMIN E EMRIT TË KRYETARIT TË PARTISË SOCIALDEMOKRATE TË SHQIPËRISË Z. SKËNDER GJINUSHI**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 06.06.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

shqyrtoi çështjen me:

**OBJEKT:** Për shqyrtimin e kërkesës për zëvendësimin e emrit të kryetarit të partisë Socialdemokrate të Shqipërisë z. Skënder Gjinushi.

**BAZA LIGJORE:** Neni 23, pika 1, germa "a", neni 64, neni 67, pika 2, neni 98 pika 4 të Ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë"

KQZ pasi shqyrtoi dokumentacionin dhe propozimet e paraqitur,

**V Ë R E N**

Presidenti i Republikës, në mbështetje të nenit 92, shkronja "gj", dhe nenin 93 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe të nenit 9, paragrafi 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, me Dekretin nr.10928, datës 05.11.2018 ka caktuar datën 30 qershor 2019, për zhvillimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore.

Partia Socialdemokrate e Shqipërisë, me shkronja nistore "PSD", nëpërmjet Kryetarit të saj, z. Skënder Gjinushi, ka paraqitur pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën dhe dokumentacionin përkatës për t'u regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore që do të zhvillohen më datë 30 qershor 2019, administruar me nr.2171 prot., datë 04.04.2019.

**Nr. 827 i Vendimit    Data 06.06.2019 e Vendimit    Ora 18:00 e vendimit**

Për shqyrtimin e kërkesës për zëvendësimin e emrit të kryetarit të partisë Socialdemokrate të Shqipërisë z. Skënder Gjinushi.



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 139 datë 09.04.2019 u regjistrua "Partia Socialdemokrate e Shqipërisë", me kryetar z.Skënder Gjinushi, dhe shkronja nistore "PSD", si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.

Referuar vendimit me nr. 11 datë 18.01.2019 të KQZ-së "Për miratimin e modelit dhe specifikimeve teknike të fletëve të votimit për zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore, të datës 30 Qershor 2019", në spëcifikimet e fletës për kandidatë për anëtar për këshillin është dhe emri i kryetarit të partisë.

Komisioni Qendror I Zgjedhjeve, në mbështetje të nenit 98 të Kodit Zgjedhor me vendimin me nr. 728 datë 30.05.2019 ka miratuar rezultatin e shortit duke përcaktuar numrin rendor që do të ketë çdo subjekt zgjedhor në fletën e votimit.

Bazuar në nenin 64, nenin 67 të Ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" si dhe në vendimin nr. 139 datë 09.04.2019 të regjistrimit të Partisë Socialdemokrate, vendimin me nr. 11 datë 18.01.2019 të KQZ-së "Për miratimin e modelit dhe specifikimeve teknike të fletëve të votimit për zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore, të datës 30 Qershor 2019", vendimin me nr. 728 datë 30.05.2019 "Për miratimin e rezultatit të shortit për përcaktimin e renditjes së subjekteve zgjedhore në fletën e votimit për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të vitit 2019", Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka miratuar përmbajtjet së fletëve të votimit për kandidatët për Këshillat Bashkiak, për 61 bashki për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 Qershor 2019 duke shënuar dhe emrin e z. Skënder Gjinushi.

Partia Socialdemokrate e Shqipërisë, me shkresën me nr. 5031 prot., datë 31.05.2019 ka paraqitur kërkesën për zëvendësim të kryetarit të Partisë Socialdemokrate të Shqipërisë z.Skënder Gjinushi me emrin e personit të koptuar z. Ëngjëll Bejtaj.

Referuar kërkesës së paraqitur z. Skënder Gjinushi më datë 15.05.2019 ka dhënë dorëheqjen e parevokueshme nga posti i kryetarit të Partisë për rrjedhojë ky këshill në bazë të statutit të partisë ka ngarkuar me këtë detyrë deri në zhvillimin e Kongresit Zgjedhor zv.kryetarin z. Engjell Bejtaj.

Për sa më sipër Partia Socialdemokrate e Shqipërisë kërkon zëvendësimin e emrit z.Skënder Gjinushi me emrin e personit të koptuar z. Ëngjëll Bejtaj në aktet e regjistrimit si subjekt zgjedhor të PSD për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.

Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve shqyrtoi kërkesën e paraqitur konstatoi se:

Në momentin e regjistrimit si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019, gjendja juridike e "Partisë Socialdemokrate e Shqipërisë", rezultonte me kryetar z.Skënder Gjinushi.

Referuar nenit 98, pika 3 të Kodit Zgjedhor, "përmbajtja e fletës së votimit" emrat e subjekteve zgjedhore vendosen në fletën e votimit, sipas rendit të përcaktuar në mënyrë të rastësishme nga shorti. Përbri emrit të partisë vendoset sigla, shkronja nistore dhe emri i kryetarit të partisë.

Ne datën e depozitimit të kërkesës së Partisë Socialdemokrate, me objekt, për zëvendësimin e kryetarit të Partisë Socialdemokrate të Shqipërisë z.Skënder Gjinushi me emrin e personit të koptuar z. Ëngjëll Bejtaj, KQZ nuk ka miratuar përmbajtjen e fletës së votimit për kandidatët për Këshillat Bashkiak, për të gjitha bashkitë. Gjithashtu dhe në rastet e miratimit të përmbajtjes së fletës së votimit për disa bashki, prodhimi dhe printimi i tyre nuk është realizuar ende.

Rezulton se në momentin e miratimit të përmbajtjes së fletës së votimit, gjendja faktike dhe juridike e Partisë Socialdemokrate ka ndryshuar, kryetari i koptuar i partisë tashmë është z. Engjell Bejtja, pasi z. Skënder Gjinushi ka dhënë dorëheqjen. Përmbajtja e fletës së votimit e cila do të përdoret nga zgjedhësit për të votuar në ditën e zgjedhjeve, duhet të pasqyrojë gjendjen



aktuale të Partisë Socialdemokrate, pasi përpos ndryshimit në Gjykatën e Shkqllës së Parë Tiranë të kryetarit të partisë, ky ndryshim është i mundëshëm dhe teknikisht për t'u kryer.

Në këto kushtë, referuar nenit 98, pika 3 të të Ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" në fletën e votimit përbri emrit të Partisë Socialdemokrate duhet të vendoset sigla, shkronja nistore dhe emri i kryetarit të partisë, z. Engjëll Bejtja, për sa kohë në momentin e miratimit të përmbajtjet së fletëve të votimit për kandidatët për Këshillat Bashkiak z. Skëndër Gjinushi ka dhënë dorëheqien si dhe duke qënë se prodhimi i fletëve të votimit për kandidatët për Këshillat Bashkiak nuk ka filluar.

Për sa më lartë KQZ konstaton se kërkesa e Partisë Socialdemokratë për zëvendësimin e emrit të kryetarit duhet të pranohet, si e mbështetur ne Kodin Zgjedhor.

### **PËR KËTO ARSYE**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve mbështetur në 23, pika 1, germa "a", neni 64, neni 67, pika 2, neni 98 pika 4 të Ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë":

### **V E N D O S I:**

1. Pranimin e kërkesës për zëvendësimin e emrit të kryetarit të partisë Socialdemokrate të Shqipërisë z. Skënder Gjinushi me z. Engjëll Bejtaj.
2. Ky ndryshim të reflektohet në vendimet e miratimit të përmbajtjes së fletës së votimit për kandidatët për Këshillin Bashkiak.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

<b>Klement</b>	<b>ZGURI -</b>	<b>Kryetar</b>
<b>Denar</b>	<b>BIBA -</b>	<b>Zv/Kryetar</b>
<b>Bledar</b>	<b>SKËNDERI-</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Edlira</b>	<b>JORGAQI-</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Rezarta</b>	<b>BITRI</b>	<b>Anëtare</b>

---

**Nr. 827 i Vendimit    Data 06.06.2019 e Vendimit    Ora 18:00 e vendimit**

Për shqyrtimin e kërkesës për zëvendësimin e emrit të kryetarit të partisë Socialdemokrate të Shqipërisë z. Skënder Gjinushi.

